



e Rahovecit

Përmirësim i infrastrukturës rrugore me gjatësi prej 22 kilometrash

Komuna e Rahovecit nënshkroi kontratën me «Lika Company Sh.P.K. Për projektin e asfaltimit me gjatësi prej 22 kilometrash. Ky projekt përfshin dy segmente rrugore: Rahovec - Drenoc - Senoc - Pastasel - Polluzhë - Sarosh dhe segmentin tjetër nga Drenoci në drejtim të Pataqanit të Epërm e të Poshtëm deri në Fortesë, duke përfshirë edhe rrethrotullimin mes Sapniqit dhe Fortesës.

Në projekt përfshihet: riasfaltimi dhe zgjerimi i rrugës, vendosja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal, si dhe ndërtimi i mureve mbrojtëse me standarde moderne.

Vlera e përgjithshme e këtij projekti është 3.863.123.57 euro dhe realizimi i tij po bëhet përmes bashkëfinancimit me Ministrinë e Infrastrukturës



Transparenca triumfon në Rahovec

Sipas rezultateve për transparencën buxhetore për vitin 2024, Komuna e Rahovecit është renditur në vendin e parë, me 100 pikë, një sukses dhe dëshmi e qartë e përkushtimit tonë për qeverisje të hapur, llogaridhënëse dhe në shërbim të qytetarëve.

